



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE
(Provim me zgjedhje për shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik)

DEGA:

ART FIGURATIV

LËNDA:

HISTORI ARTI ME ZGJEDHJE

VITI SHKOLLOR 2019 -2020

KOORDINATORE: MAJLINDA HALA

I. HYRJE

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Histori arti” përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të “Historisë së artit” për shkollën e mesme me drejtim të orientuar artistike.

Programi orientues për provimin me zgjedhje “Histori arti”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2019-2020, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega “Art figurativ”, për nxënësit e interesuar dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit që japin lëndën e “Historisë së artit” në shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega “Art figurativ”, që do të përgatisin maturantët për provimin “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore*, që ata duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar* që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi orientues “Histori arti” synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë dhe është strukturuar në bazë të disa rubrikave që ndjekin dhe sqarojnë njëra-tjetrën.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe korrektësi nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos kujdes duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Histori arti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore, **të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program.**

Vëmendje duhet të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program me përqindjet që zënë këto tema në testin e

provimit. Përgatitja e nxënësve për provimin “Histori arti” duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh. Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve të historisë së artit dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, herë-herë ata duhet t’u rikthehen dhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përmbajnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

II. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues i lëndës me zgjedhje “Histori arti” për provimin e Maturës Shtetërore të klasës XII bazohet në parimin se të zotërosh njohuri artistike do të thotë të jesh në gjendje t’i zbatosh ato:

- në tematika të ndryshme të vetë lëndës “Histori arti”;
- në situata të jetës së përditshme.

Programi orientues për përgatitjen e provimit me zgjedhje të lëndës “Histori arti” është mbështetur në programet e lëndës “Histori arti”, klasat 11-12 të;

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban *strukturën e testit* në të cilën tematikat si dhe pesha e tyre.

Programi përmban rubrikën *e njohurive dhe rezultateve të të nxënësve* ku përcaktohen njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore për çdo tematikë të lëndës “Histori arti”.

III. STRUKTURA E TESTIT

Një nga aspektet më të rëndësishme në lëndën “Histori arti: është zhvillimi i njohurive artistike në njohjen, gjykimin dhe vlerësimin e artit në përgjithësi, ndikimin e artit në jetën kulturore, shkencore, politike, artistike të vendeve ku është krijuar, dhe vlerësimin e veprave të përfaqësuesve të ndryshëm duke evidentuar dhe analizuar karakteristikat dhe risitë e çdo artisti.

Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale** të lëndës së Histori arti përgjatë viteve të shkollimit në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënësve që duhet të demonstrojnë nxënësi në përmbushjen e njohurive artistike. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje. Në

përgatitjen për përmbushjen e këtij programi orientues do të përdoren programet e lëndës Histori arti dhe literatura dhe tekstet me të cilat këto shkolla zhvillojnë studimin e kësaj lënde.

Nr	Tematika	Pesha	Përmbajtja sipas tematikave
1.	Arti figurativ në Antikitete (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)	10 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti i mbretërive të vjetra: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kultura Egjiptiane</i> - <i>Arti asiro – babilonas ose i Mesopotamisë;</i> - <i>3 periudhat e artit grek;</i> - <i>Arti romak – arkitektura dhe skulptura romake.</i> • Ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore; • Roli dhe besimi në zhvillimin e artit të këtyre kulturave, mënyrën e qeverisjes dhe të organizimit të jetës shoqërore; • Zhvillimi i skulpturës monumentale, të varrit, pikturën, arkitekturën, idenë mbi të bukurën dhe kanunet.
2.	Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)	5 %	<p>Arti në periudhën e Mesjetës</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Arti bizantin: katedralet: Shën Sofi, Shën Vital, Shën Mark;</i> • <i>Arti romanik: Duomo i Pizës;</i> • <i>Arti gotik: arkitektura gotike në Francë;</i> • <i>Pararilindja dhe Kristianizmi në Europë: Pizano dhe Xhoto (Pisano, Giotto)</i>
3.	Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)	10%	<p>Arti figurativ në periudhën e Rilindjes Europiane përmes njohjes me përfaqësuesit dhe me veprat e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rilindja e hershme: <ul style="list-style-type: none"> - Donatelo (Donatello) - Filipo Bruneleski (Filippo Brunelleschi)

			<ul style="list-style-type: none"> - Mazacio (Masaccio) • Rilindja Flamande: <ul style="list-style-type: none"> - Vëllezërit Van Eyck (Hubert dhe Jan van Eyck) - Hugo van der Goes (Hugo van der Goes) - Rozhier van der Veiden (Rogier van der Weyden) - etj. • Rilindja gjermane <ul style="list-style-type: none"> - Albert Durer - Matias Grynvalt (Matthias Grunewald) - Hans Holbejn (Hans Holbein) - Etj. • Rilindja e largët Itali <ul style="list-style-type: none"> - Leonardo da Vinci - Mikelanxhelo (Mmichelangelo Buonarroti) - Rafaelo (Raffaello Sanzio) • Rilindja Veneciane <ul style="list-style-type: none"> - Xhorxhione (Giorgio Barbarelli da Castelfranco) - Ticiani (Tiziano Vecellio) - Veroneze (Veronese)
4.	Arti barok (shekujt XVII - XVIII)	10 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti në periudhën e Barokut përmes: Tipareve, veprave dhe risive të përfaqësuesve kryesore. • Art Barok Itali <ul style="list-style-type: none"> - Kavaraxho (Michelangelo Merisi da Caravaggio) - Lorenzo Bernini (Gian Lorenzo Bernini) • Arti Barok në Spanjë <ul style="list-style-type: none"> - Esteban Murijo (Esteban Murillo) - El Greko (El Greco) - Velaskes (Diego Velázquez) - Goja (Francisco Goya) - Etj. • Arti Barok Flande dhe Hollandë

			<ul style="list-style-type: none"> - Rubens (Peter Paul Rubens) - Van Deik (Anthony van Dyck) - Rembrand (Rembrandt van Rijn) - Franc Hals (Frans Hals) - Vermer (Johannes Vermeer) - Etj. • Arti Barok dhe Rokokoja në Francë - Nikolas Pusin (Nicolas Poussin) - Klod Loran (Claude Lorrain) - Pjer Puzhe (Pierre Puget) - Zhyl Mansar (Jules Mansart) - Antuan Vato (Jean-Antoine Watteau) - Fransua Bushe (François Boucher) - Simeon Shardë (Jean-Baptiste-Siméon Chardin) - Zhan Honore Frangomer (Jean-Honoré Fragonard) - Etj. -
5.	Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)	15 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti në periudhën e Kohës së Re. Neoklasiçizmi - Zhak Lui David (Jacques-Louis David) - Antonio Konova (Antonio Canova) - Bertel Torvaldsen (Bertel Thorvaldsen) Arti romantik - Teodor Zheriko (Théodore Géricault) - Ezhen Delakrua (Eugène Delacroix) - Etj. Arti në Rusi - Ivan Surikov (Vasily Ivanovich Surikov) - Etj. Arti realist

			<ul style="list-style-type: none"> - Xhon Kostable (John Constable) - Uilliam Tërner (Joseph Mallord William Turner) - Shkolla Barbizon - Gustav Kurbe (Gustave Courbet) - Honore Domie (Honoré Daumier) - August Roden (Auguste Rodin) <p>Arti nuovo</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viktor Horte (Victor Horta) <p>Impresionizmi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klod Mone (Claude Monet) - Eduard Mane (Édouard Manet) - Edgar Degar (Edgar Degas) - August Renuar (Pierre-Auguste Renoir) - Etj. <p>Postimpresionizmi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pol Sezan (Paul Cézanne) - Vinsent Van Gog (Vincent van Gogh) - Pol Gogen (Paul Gauguin) - Zhorzh Sera (Georges-Pierre Seurat) - Etj.
6.	Arti në shekullin XX	15 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti figurativ në gjysmën e parë të shekullit XX: • Pikturë <ul style="list-style-type: none"> - Matis (Henri Matisse) - Xhorxh Brak (Georges Braque) - Vasili Kandiskij - Emil Nolde - Umberto Boçioni (Umberto Boccioni) - Salvador Dali - Marsel Dyshamp (Marcel Duchamp)

			<ul style="list-style-type: none"> - Etj. • Arkitektura - Antonio Gaudi - Roe Vandernies - Valter Gropius (Walter Gropius) • Skulpturë - Emil Burdel (Émile Antoine Bordelles) • Arti i postimpresionistëve dhe lëvizje të reja avangardë.
7.	Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare	5 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare: - Butrinti - Apollonia - Dyrrahu - Orikumi
8.	Arti bizantin	5 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti bizantin - arkitektura: - Kisha e Shën Kollit, Perondi – Kuçovë - Manastiri i Mesopotamisë – Delvinë - Kisha e Shën Vllahernës, Berat - Kisha e Shën Marisë, -Kosinë – Përmet. - Etj. • Piktura - Pikturat e kishës së Bllashtanjës - Pikturat e manastirit të Pojanot – Fier - Ishulli – Mali i Gradit - Shën Jovani - Boboshticë
9.	Arti pasbizantin	5 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti pas bizantin: - Onufri - Nikolla Onufri – i biri

			<ul style="list-style-type: none"> - Onufri qiprioti - David Selenicasi - Kostandin Shpataraku - Vëllezërit Zograf - Vëllezërit Çetini
10.	Art i Rilindjes Kombëtare Shqiptare	5 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare: - Kol Idromeno - Jorgji Panariti - Spiro Xega - Murat Toptani - Simon Rrota - Ndoc Martin Camaj
11.	Arti i periudhës së Pavarësisë	5 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti i periudhës së Pavarësisë: Piktura - Vangjus Mio - Andrea Kushi - Zef Kolumbi Skulptura - Odhise Paskali
12.	Arti i periudhës së pas çlirimit (1945 deri më sot)	10 %	<ul style="list-style-type: none"> • Arti i periudhës pas Çlirimit (1945 deri më sot): Piktura - Sadik Kaceli - Abdurrahim Buza - Nexhmedin Zajmi - Kel Kodheli - Guri Madhi - Fatmir Haxhiu - Vilson Kilica - Zef Shoshi

			<ul style="list-style-type: none"> - Sali Shijaku - Danish Shukriu - Ismail Lukani - Etj <p>Skulptura</p> <ul style="list-style-type: none"> - Odhise Paskali - Andrea Mano - Janaq Pano - Llazar Nikolla - Kristaq Rama - Shaban Hadëri - Muntaz Dhrahmi - Hektor Dule - Perikli Çuli - Fuat Dushku - Etj. <ul style="list-style-type: none"> - Ibrahim Kodra - Mysli Mulliqi - Shyqyri Nimani - Etj.
--	--	--	--

IV. TABELA E REZULTATEVE TË TË NXËNËIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënësve që duhet të demonstrojnë njohuritë për të përmbushur kompetencat artistike nëpërmjet lëndës “Histori arti”. Megjithatë njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.

TEMATIKA: Arti figurativ në Antikitët (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
Arti figurativ në Antikitët (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none">- njohin zhvillimin e artit figurativ në antikitët.- shpjegojnë sistemin shoqëror dhe risitë e kësaj periudhe.- analizojnë gjinitë e artit sipas epokave.- përcaktojnë format dhe teknikat.- shpjegojnë tiparet kryesore të kësaj periudhe.

TEMATIKA: Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none">- njohin zhvillimin e artit figurativ në Mesjetë.- shpjegojnë rolin e kishës, fuqizimin e feudalizmit, kërkesa e tyre, zhvillimet sociale.- shpjegojnë:<ul style="list-style-type: none">○ <i>karakteristikat e artit biznatin;</i>○ <i>karakteristikat e artit romanik;</i>○ <i>karakteristikat e artit gotik;</i>○ <i>karakteristikat e artit të Pararilindjes;</i>- krahasojnë periudhat midis tyre.

TEMATIKA: Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e artit figurativ në Rilindjen Europiane. - kuptojnë ndikimin e zhvillimeve shoqërore, historike dhe artistike në artin figurativ. - shpjegojnë karakteristikat e kësaj periudhe, si: <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Forcimi i borgjezisë.</i> ○ <i>Zbulimet e mëdha gjeografike.</i> ○ <i>Reformacioni i kishës.</i> ○ <i>Zhvillimi i teknikës.</i> ○ <i>Filozofia humaniste.</i> - njohin autorët kryesorë dhe veprat e tyre. - argumentojnë rreth përsosjes së teknikave artistike në artet figurative. - bëjnë dallimet në kohë dhe në hapësirë.

TEMATIKA: Arti barok (shekujt XVII - XVIII)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
Arti barok (shekulli XVII - XVIII)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e artit barok dhe vendet ku u zhvillua. - shpjegojnë diferencat kulturore midis vendeve të ndryshme dhe artistëve të tyre. - shpjegojnë zhvillimin e artit; - argumentojnë pse arti në këtë periudhë ishte në shërbim të fesë dhe politikës.

	<ul style="list-style-type: none"> - njohin veprat e autorëve kryesorë të kësaj periudhe. - shpjegojnë zhanret kryesore dhe evoluimin e teknikave artistike.
--	--

TEMATIKA: Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e artit të Kohës së Re. - shpjegojnë zhvillimet historike, terrenin social ekonomik ku u zhvilluan. - kuptojnë Revolucionit tekniko shkencor dhe risitë. - shpjegojnë ndarjen e epokave dhe dallimet midis rrymave. - njohin veprat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe. - shpjegojnë zhvillimet teknologjike dhe jetën moderne.

TEMATIKA: Arti në shekullin XX

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
Arti në shekullin XX	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e artit në shekullin XX. - Të shpjegojnë rolin e politikës dhe të ekonomisë. - njohin dhe të përcaktojnë artistët novatorë. - shpjegojnë ndryshimet e vazhdueshme të artit në këtë periudhë; - përcaktojnë qartë rrymat artistike dhe autorët. - njohin veprat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe.

	- shpjegojnë ndryshimet në përmbajtje dhe zhvillimet e teknologjisë.
--	--

TEMATIKA: Arti figurativ shqiptar

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxëniet për realizimin e kompetencave artistike
Arti figurativ shqiptar	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin zhvillimin e arkitekturës, skulpturës dhe artizanatit në artin ilir. - kuptojnë huazimet nga kulturat greke dhe romake në artin ilir. - bëjnë dallimin midis artit ilir dhe atij me ndikime greko-romake. - japin shembuj konkretë me toponime dhe data. - njohin epokën kur lindi arti bizantin në Shqipëri. - njohin karakteristikat kryesore të artit bizantin. - përcaktojnë tiparet e veprave, dhe vendndodhjen e tyre. - njohin artistë të kësaj periudhe. - shpjegojnë pse Kristianizmi ishte sunduesi i botës shpirtërore të njeriut në këtë periudhë. - shpjegojnë pse piktura për njeriun është si Bibla për atë që di të lexojë. - njohin rolin vendimtar të pikturës pas bizantine, si themel i trashëgimisë historike, kulturore dhe shpirtërore. - njohin autorët kryesore të periudhës pas bizantine dhe veprat e tyre. - kuptojnë se si ndodhi shkëputja përfundimtare nga arti mesjetar. - shpjegojnë tiparet kombëtare të artit të periudhës së

	<p>Rilindjes, të shprehura në punët e artistëve patriotë me formim perëndimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktojnë autorët dhe veprat e tyre në periudhën e Rilindjes Kombëtare. - kuptojnë rolin patriotik të krijimtarisë artistike në periudhën e Rilindjes Kombëtare. - njohin periudhën e Pavarësisë dhe zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike. - shpjegojnë disa nga kërkesat që shtroheshin për zgjidhje dhe evolucionin e artit figurativ. - përcaktojnë rritjen e artit shqiptar në periudhën e Pavarësisë. - njohin autorët kryesorë në skulpturë dhe pikturë dhe veprat e tyre, në periudhën e Pavarësisë. - njohin rolin e artit në periudhën e realizmit socialist. - shpjegojnë çfarë është tabloja kompozicionale tematike në shërbim të ideologjisë. - kuptojnë rolin e institucioneve shtetërore artistike gjatë periudhës së viteve 1945 - 1990. - njohin skulpturat monumentale politike. - kuptojnë zhvillimet në varësi të trysnive politike. - njohin autorët kryesorë dhe veprat e tyre sipas gjinive të artit. - njohin autorët kryesorë të trevave shqiptare.
--	---